



Pranuar / Dorezuar Priljenof/Prodato Received/Delivery	25.05.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHIC	3031/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.386/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca- anëtarë me Ardita Perçuku-Shyti -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.386/2022 të datës 15.04.2022, të parashtruar nga grup ankuesish

dhe të cilët me autorizim i përfaqëson me adresë banimi e kundër organit të punësimit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 24.05.2022, në mënyrë unanime mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **Shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.386/2022 të datës 15.04.2022 të parashtruar nga grup ankuesish

A r s y e t i m

Ankuesit dhe janë të punësuar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti i Makinerisë.

Me datën 03.03.2022, përfaqësuesi i ankuesve Av. përmes Postës së Kosovës ka parashtruar kërkesë-ankesë pranë Këshillit Drejtues dhe Komisionit për Konteste dhe Ankesa të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", e cila është pranuar me datën 07.03.2022 nga organi i punësimit, lidhur me kompensimin e shtesës prej 30 eurove, bazuar në vendimin e Qeverisë së



Republikës së Kosovës me numër nr.05/24 të datës 12.01.2018. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", nuk ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesën-ankesën e ankuesit për kompensim material.

Përfaqësuesi ligjor i ankuesve i pakënaqur me mos përgjigje nga ana e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me datën 15.04.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2156/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin e shtesës prej 30 eurove, bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër nr.05/24 të datës 12.01.2018.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 22.04.2022, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 2355/2022 për përgjigje në ankesë tek Universiteti i Prishtinës, ndërsa me datën 05.05.2022 përmes shkresës me numër protokollit 2590/2022, Universiteti i Prishtinës ka kthyer përgjigjen në ankesën e ankuesve me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2156/2022 të datës 15.04.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 08.04.2021 nga përfaqësuesi ligjor i ankuesve; Autorizimin e datës 08.04.2021 nga përfaqësuesi ligjor i ankuesve; Kërkesën e datës 03.03.2022 të parashtruar nga përfaqësuesi ligjor i ankuesve për në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Dëftesën mbi pranimin e dërgesës postare me numër serik 25901202266788 të datës 07.03.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 22.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 11.05.2022 nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin me numër protokollit 2/995 të datës 04.11.2021 nga Universiteti i Prishtinës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve

dhe **SEPSE:**

Nga shqyrtimi i provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës të ofruara nga palët, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ankuesit janë të punësuar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Makinerisë, rrethanë e konfirmuar përmes autorizimeve për përfaqësim në lidhje me këtë kërkesë, autorizime që gjenden në shkresat e lëndës.

Ankuesit me datë 03.03.2022 kanë parashtruar kërkesë-ankesë pranë Këshillit Drejtues dhe Komisionit për Konteste dhe Ankesa të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", lidhur me kompensimin e shtesës prej 30 eurove, bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.05/24 të datës 12.01.2018. Pas heshtjes së organit të punësimit, ankuesit përmes përfaqësuesit me autorizim kanë ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e së drejtës së kompensimit të shtesës prej tridhjetë (30) euro bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 05/24 të datës 12.01.2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të pranueshmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 2 paragrafit 3 ku përcaktohet se 3. *Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke*



filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. 4. Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se zyrtarët publikë të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovës, kanë statusin e nëpunësit të shërbimeve publike, respektivisht të njëjtit nuk janë nëpunës civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ku përcaktohet se këshilli është kompetent të: "1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në Shërbim Civil", Mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.386/2022 të datës 15.04.2022 të parashtruar nga ankuesit si në hyrje dhe dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në dispozitat e nenit 24 dhe 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se zyrtarët publikë me status të nëpunësit të shërbimit publik kanë të drejtë të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nenparagrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.386/2022, datë 24/05/2022

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Përfaqësuesit ligjor të ankuesve
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Universitetin e Prishtinës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Universitetin e Prishtinës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.